



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

## STATUTI I FEDERATËS SË MUNDJES TË KOSOVËS

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### PREAMBULA

Federata e Mundjës e Kosovës është themeluar më 04.12.2000 dhe është anëtare e Federatës Botërore të Mundjes (United World Wrestling ) prej vitit 2016 . Federata e Mundjes e Kosovës është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës.

Federata e Mundjës e Kosovës është entiteti i vetëm kompetent për të organizuar te përmirësojë dhe te avancoj sportin e mundjes në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

#### NENI 1

#### FORMA JURIDIKE ,EMRI,FORMA ADRESA DHE SELIA

1. Federata e Mundjës e Kosovës është person juridik, e organizuar si Federatë, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të klubeve sportive të Mundjës në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në përputhje me Ligjin për Sport ligjit nr. 04/L-075, ligji për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare (nr. 06/l-043), dhe mbi statutin e KOK,UWW-se normat dhe parimet e përcaktuara nga Federata Botërore e Mundjes.

2.Emri i Federatës është:

#### FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVO WRESTLING FEDERATION

3. Akronimi i Federata e Mundjes e Kosovës është FMK.

4.Federata e Mundjes e Kosovës posedon edhe xhirollogarinë e vetë;

5. Federata e ka logon, vulën dhe flamurin e vet. Logoja është e përbërë prej dy mundësav ne prapavij është harta e Kosovës si dhe përmban mbishkrimin Federata e Mundjës e Kosovës ne anen e sipërme gjithashtu edhe mbishkrimin ne gjuhen angleze.

6.Flamuri i Federatës ka formën e njëjtë sikurse logoja me matrial te menndafshte

7. Selia e Federatës se Mundjës e Kosovës është në Prishtinë, Adresa: Shtëpia e sporteve (House of Sport) Kati II, nr.31 Rr. Agim Ramadani nr.253, 10000 Prishtinë, Kosovë



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

## NENI 2 QËLLIMET E FEDERATËS

Qëllimet e FMK-së janë:

- a) Në mënyrë të ndershme të promovoj vlerat të saj bashkuese, edukative, kulturore dhe humanitare, veçanërisht përmes programeve të zhvillimit;
- b) Të organizojë garat në të gjitha format e njohura nga UWW duke përfshirë në nivel kombëtar , ndërkombëtar, duke përcaktuar saktësisht, fushat e kompetencave dhe të drejtën e delelegimit për garat e ndryshme (nëse ka të tilla) që përfshihen në FMK;
- c) Të hartojë rregullore dhe dispozita dhe të sigurojë zbatimin e tyre;
- d) Të mbrojnë interesat e Mundjës dhe të anëtarëve të saj, dhe të ndihmojë anëtarët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre;
- e) Të kontrollojë dhe të parandalojë çdo shkelje të statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të UWW-s KOK dhe FMK-së si dhe rregullave të garave , dhe të sigurojë që ato të respektohen edhe nga anëtarët, klubet, mundësat-et, zyrtarët, agjentët dhe ndërmjetësit;
- f) Të promovojë integritetin, etikën dhe garën e ndershme me qëllim parandalimin e të gjitha metodave ose praktikave, të tilla si korrupsioni, dopingut ose manipulimi e garave , të cilat mund të rrezikojnë integritetin e garave , disiplinave , mundësav-e, zyrtarëve dhe anëtarëve ose të shkaktojnë abuzim me sportin e mundjës.
- g) Të promovojë dhe të forcojë parimet dhe praktikat e qeverisjes së mirë në nivelin kombëtar dhe të inkurajojë anëtarët e saj të miratojnë parimet e qeverisjes së mirë, brenda vetë anëtarëve;
- h) Të promovojë zhvillimin e mundjes të femrat dhe pjesëmarrjen e plotë të femrave në të gjitha nivelet e qeverisjes së mundjës ;
- i) Të kontrollojë dhe të mbikëqyrë të gjitha garat e mundjës në të gjitha format në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- j) Të kontrollojë dhe të mbikëqyrë te gjitha format e garave ndërkombëtare të Mundjës të zhvilluara në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me statutin dhe rregulloret përkatëse të UWW-s;
- k) Të administrojë marrëdhëniet sportive ndërkombëtare të lidhura me mundje, me të gjithë partnerët (p.sh. UWW dhe , Komitetin Olimpik të Kosovës);
- l) Të organizojë gara pritëse në nivele ndërkombëtare dhe nivele të tjera;
- m) Të promovojë dhe të mbështesë iniciativat e anëtarëve të saj, për rritjen e të ardhurave të tyre në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës;
- n) Të sigurojë transparencë dhe të bëjë publike aktivitetet e FMK-së, për sa është e mundur, dhe raportet financiare vjetore të saj.
- o) Parandalimin dhe Luftimi i dopingut në sportin e mundjës.

## NENI 3 DETYRIMET

FMK merr përsipër:

- a) Të investojë të organizojë aktivitetin e sajë në sportin e mundjës;
- b) Të respektojë në çdo kohë statutin, rregulloret, vendimet e UWW-s, FMK, KOK-ut, Kodin e Etikës së UWW, vendimet e CAS-it dhe rregulloret të tjera të detyrueshme për FMK-në;;
- c) Të respektojë **ligji nr. 06/l-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive ;**
- ç) Të luajë rol aktiv lidhur me aktivitetet sportive të UWW-s;
- d) Të respektojë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sportivitetit në frymën e ferpleit;
- e) Të respektojë rregullat e garave të miratuara nga UWW dhe FMK;



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

- f) Të njohë juridiksionin e CAS-it, siç specifikohet në dispozitat përkatëse të statuteve të UWW-s dhe FMK-s
- g) Të administrojë punët e saj në mënyrë të pavarur dhe të sigurojë që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë dhe të parashikojë një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve të anëtarëve të organeve të FMK-së, në veçanti një procedurë e cila është e pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim i papërshtatshëm politik;
- h) Të veprojnë në përputhje me konventat e Anti-Dopingut dhe dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi;
- i) Të sigurojë që anëtarët, klubet, mundësat, zyrtarët të bien dakord, se përmes statuteve të tyre, licencës, regjistrimit ose çdo dokumenti tjetër të shkruar, do të respektojnë detyrimet e sipërpërmendura;
- j) Të komunikojë me UWW-n ,MKRS,KOK çdo ndryshim të statutit të FMK-së përmes përkthimit, nëse është e nevojshme, në një gjuhë zyrtare të UWW-s

### NENI 4

#### TË DREJTAT E NJERIUT

FMK është e angazhuar të respektojë të drejtat e njeriut.

### NENI 5

#### MOSDISKRIMINIMI DHE BARAZIA

Diskriminimi i çdo lloji kundër një vendi, personi privat ose grupi të njerëzve për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës etnike, kombëtare ose shoqërore, gjinisë, paaftësisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose ndonjë mendimi tjetër, pasurisë, lindjes ose ndonjë tjetër statusi, orientimi seksual ose ndonjë arsye tjetër është rreptësisht e ndaluar dhe i dënueshëm me pezullim ose dëbim dhe/ose masa të tjera disiplinore

### NENI 6

#### NEUTRALITETI DHE PAVARËSIA INSTITUCIONALE

1. FMK është neutrale lidhur me çështjet e politikës dhe të fesë.
2. Anëtarët e FMK-së do të jenë gjithashtu neutralë lidhur me çështjet e politikës dhe fesë dhe do të sigurojnë që anëtarët e tyre të qëndrojnë neutralë në këto çështje.
3. FMK mbetet e pavarur dhe shmang çdo formë të ndërhyrjeve të papërshtatshme politike. FMK i menaxhon punët e saj në mënyrë të pavarur dhe sigurohet që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë.

### NENI 7

#### PROMOVIMI I MARRËDHËNIEVE MIQËSORE

1. FMK do të promovojë marrëdhënie miqësore midis anëtarëve të saj, klubeve, zyrtarëve, mundësav-e etj.
2. FMK do të sigurojë mjetet e nevojshme institucionale për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje të brendshme që mund të lindë midis anëtarëve, klubeve, zyrtarëve dhe mundësav-e,referve etj.

### NENI 8

#### GARAT DHE TË DREJTAT NË GARA DHE NË AKTIVITET

- 1.FMK zhvillon aktivitete në Republikën e Kosovës përmes organizimit të garave kombëtare, rajonale, ndërkombëtare etj.
2. Bordi mund të shtojë gara që nuk parashikohen në paragrafin 2 më sipër, dhe mund të vendosë pezullimin e përkohshëm të një ose më shumë nga garat e mësipërme.
3. Çdo subjekt i interesuar për të organizuar një ose më shumë gara jashtë kalendarit të garave të miratuar nga FMK, ose aktivitete të veçanta të mundjes në Republikën e Kosovës, duhet së pari të marrë leje nga FMK për këtë qëllim.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

4. Kompetenca për organizimin e garave ndërkombëtare midis klubeve reprezentacionit i takon vetëm UWW-s dhe FMK-së. Asnjë garë e tillë nuk do të zhvillohet pa lejen paraprake të UWW-s dhe/ose FMK-së në përputhje me këtë statut.

5. FMK është e detyruar të respektojë kalendarin e garave ndërkombëtare të përpiluar nga UWW-s.

6. FMK dhe secili nga anëtarët e saj do të bëjë gara në përputhje me Rregulloren e garave të nxjerra nga UWW dhe FMK.

7. Vetëm UWW mund të vendosë dhe të ndryshojë rregullat e garave.

### NENI 9

#### REPREZENTACIONI

1. Ngjyrat e fanellave të reprezentacionit shtetëror të Mundjes të Kosovës dhe detajet tjera vendosen nga bordi i FMK-s.

2. Selektorët e reprezentacionit janë të emëruar nga bordi i FMK. bazuar në propozimet e Këshillit Profesional të FMK. Mandati i tyre është një vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Selektori duhet të jete trajner i ndonjë klubi të mundjës po ashtu të ketë një provoj sportiv me suksese të deshmuar në sportin e mundjes.

4. Selektori i kategorisë i bën propozimet e reprezentuesve për garat ndërkombëtare kurse bordi i FMK i shqyrton dhe i miraton.

### NENI 10

#### SJELLJA E ORGANEVE, ZYRTARËVE DHE E TË TJERËVE REFERVE

1. Të gjitha organet dhe zyrtarët e FMK-së duhet të respektojnë statutin, rregulloret, vendimet, dhe Kodin e Etikës së UWW-s, dhe të FMK-së në aktivitetet e tyre, si edhe parimet e garës së drejtë, të ndershme, të integritetit dhe sportivitetit

### NENI 11

#### GJUHËT ZYRTARE

1. Gjuha zyrtare e FMK-së është gjuha shqipe. Dokumentet dhe tekstet zyrtare do të shkruhen në këtë gjuhë.

2. Gjuha zyrtare në Kuvendin e Përgjithshme është gjuha shqipe.

### ANËTARËSIA

#### NENI 12

#### PRANIMI, PEZULLIMI DHE PËRJASHTIMI

1. Vendimin për pranimin, pezullimin ose përjashtimin e një anëtari e merr Kuvendi i Përgjithshme e FMK-s

2. Pranimi bëhet nëse kandidati përmbush kërkesat e specifikuar në këtë statut.

Kuvendi i Përgjithshem mund të pranojë një kandidat për anëtarësim.

3. Anëtarësia në FMK përfundon, me anë të shpërbërjes, dorëheqjes ose përjashtimit të anëtarit. Humbja e anëtarësisë nuk e çliron anëtarin nga detyrimet e tij financiare ndaj FMK-së, ose anëtarëve të tjerë të FMK-së, të kërkueshme deri në atë moment, por çon në humbjen e të gjitha të drejtave në lidhje me FMK-në. Bordi mund të ndërmarrë çdo lloj hapi për të mbështetur anëtarin, ose mund të detyrojë pasardhësin e tij të mundshëm ligjor të përmbushë të gjitha detyrimet financiare të anëtarit të larguar para pranimit.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS

## KOSOVA WRESTLING FEDERATION

### SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

#### NENI 13

##### ANËTARËSIA

1. Anëtarësimi në FMK është ekskluzivisht i hapur për personat juridikë të përcaktuar në bazë të ligjit "Për sportin", të cilët veprojnë dhe janë të regjistruar në Republikën e Kosovës. Anëtarësimi në FMK mund të jetë:
2. Anëtarësia e FMK-së përbëhet nga:
  - a) Klubet e Mundjes;
  - b) Komisioni i trajnerve
  - c) Komisioni i referve
  - d) Perfaqësuesi i sportistave
3. FMK mban një regjistër të anëtarëve të saj. Regjistri përfshin informacionin e mëposhtëm për secilin anëtar:
  - a) numrin unik të identifikimit;
  - b) informacion shtesë, në veçanti lidhur me licencimin e klubit (p.sh. strukturën e klubit, identitetin; rezultatet), sipas vendimeve të Bordit Ekzekutiv.Informacioni i përditësuar do të bëhet publik në faqen e internetit të FMK-së.
4. Me kërkesë paraprake, FMK konfirmon me shkrim statusin e anëtarit.

#### NENI 14

##### PRANIMI

1. Çdo klub i mundjes që dëshiron të bëhet anëtar i FMK-së duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të FMK-së. Sekretari i Përgjithshëm i konfirmon kandidatit paraqitjen e kërkesës.
2. Kërkesa duhet të shoqërohet detyrimisht me dokumentet e mëposhtme:
  - a) Certifikata e OJQ kopje
  - b) Vërtetimi për regjistrim të klubit në Komunën përkatëse.
  - c) Vërtetim të personit të autorizuar të klubit nga OJQ
  - d) Një kopje të vlefshme të stautit konfor statutit të FMK-s
  - e) Një kopje të vlefshme të rregulloren e kuvendit
  - f) Një kopje të vlefshme të rregulloren e bordit
  - g) Një kopje të vlefshme të rregulloren disiplinore
  - h) Klubi duhet të ketë llogari bankare aktive.
  - i) Klubi duhet të ketë logon e dhe flamurin saj.
  - j) Klubi duhet të ketë të regjistruar se paku 10 sportist.
  - k) Klubi duhet të ketë vulën e saj.
  - l) Klubi duhet të ketë trajner të licencuar nga FMK, apo profesor të Edukatës Fizike.
  - ll) Klubi duhet të ketë palester dhe tapet të mundjes
  - m) Një deklaratë ku klubi angazhohet se do të veprojë në përputhje me statutin, rregulloret dhe vendimet e FMK-së. së, dhe UWW-s dhe të sigurojë që këto dokumente do të respektohen gjithashtu, nga anëtarët e klube, zyrtarët dhe mundesat e tij/saj (nëse është e zbatueshme);
  - n) Një deklaratë ku klubi angazhohet se do të veprojë në përputhje me rregulloren e garave në fuqi, siç përcaktohet nga UWW, FMK.
  - o) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të drejtohet si shkallë e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme të FMK-së) për çdo mosmarrëveshje të dimensionit kombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FMK-së vetëm te CAS në Kosovë.
  - p) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se përbërja e tij ligjore garanton se ai mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë subjekt i jashtëm dhe të sigurojë që çështjet e tij të mos ndikohen në mënyrë të





# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

- papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në veçanti që ai është i pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;
- q) Një deklaratë ku shprehet se anëtarët e organeve të veta janë zgjedhur ose emëruar si rezultat i një procedure që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve, nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;
- r) Një listë të zyrtarëve, duke specifikuar ata që janë përfaqësues ligjorë, me të drejtë të lidhin marrëveshje ligjërish të detyrueshme me palë të treta;
- s) Një kopje të procesverbalit të Kuvendit të fundit ose të mbledhjes themeluese;
- t) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se ai merr përsipër të organizojë ose të marrë pjesë në ndonjë garë ndërkombëtare ,mund të marrë pjesë vetëm me pëlqimin paraprak të FMK-së (nëse aplikohet)
- u) Klubi ne kuvendin themelues duhet ta ftoj FMK për monitorimin e kuvendit te klubit, qoftë zgjedhor, apo kuvend i punës, i rregullt apo i jashtëzakonshëm.
- v) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të marrë pjesë në garat zyrtare me reprezentacionin e Kosovës, përveç nëse vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente (nëse aplikohet).

### NENI 15

#### KËRKESA DHE PROCEDURA E APLIKIMIT

- Sekretariati i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kërkesave të parashikuara në këtë statut dhe përgatit një raport me shkrim për Bordin e FMK-se.
2. Bordi i FMK-se e shqyrton kërkesën e aplikuesit dhe i propozon Kuvendit të Përgjithshëm të pranohet ose të mos pranohet klubin që ka aplikuar
3. Kuvendi i Përgjithshëm i FMK-se ,i pranon anëtarët e rinj në anëtarësi të FMK-se.

### NENI 16

#### TË DREJTAT E ANËTARËV

1. Anëtarët e FMK-së gëzojnë të drejtat e mëposhtme:
- a) Të marrin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm, të njihen më parë me rendin e ditës së çdo Kuvendi të Përgjithshëm, të ftohen në Mbledhjen e Kuvendit e Përgjithshëm në kohën e përcaktuar, të ushtrojnë të drejtën për të diskutuar dhe debatuar në kuvend dhe të ushtrojnë të drejtën për të votuar. E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote.
- b) Të paraqesin propozime për t'u përfshirë në rendin e ditës së Kuvendit të Përgjithshëm. E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote.
- c) Të propozojnë kandidatë për zgjedhje dhe/ose emërim në organet përkatëse të FMK-së . E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote siç e parasheh ky statut.
- d) Të informohen për çështjet e FMK-së përmes organeve të saj zyrtare dhe të informohen për vendimet e marra nga Bordi ;
- e) Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe/ose aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FMK-ja dhe të organizojnë gara tjera pasi ti ipet e drejte nga FMK-ja dhe nën kujdesin e saj;
- f) Të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera që burojnë nga statuti dhe në përputhje me rregulloret dhe vendimet e FMK-së;
- g) Të nxjerrin rregullore vetëm në lidhje me funksionin e tyre administrativ, organizimin dhe autoritetin territorial (nëse është e rëndësishme).
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të tjera në këtë statut dhe në rregulloret e zbatueshme të FMK-së.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

### NENI 17

#### DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Anëtarët e FMK-së kanë detyrimet e mëposhtme:

- a) Të jenë besnikë ndaj FMK-së, që do të thotë se ata nuk duhet të veprojnë kundër interesave të saj;
- b) Të respektojnë plotësisht statutin, rregulloret, vendimet e UWW-s dhe FMK-së, Komisioneve në çdo kohë dhe të sigurojnë që ato të respektohen edhe nga anëtarët, mundësat dhe zyrtarët e tyre;
- c) Të sigurojnë zgjedhjen e organeve vendimmarrëse të paktën çdo 4 vjet;
- d) Të mbledhin organin e tyre më të lartë dhe legjislativ në intervale të rregullta, si rregull i përgjithshëm një herë në vit;
- e) Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FMK-ja;
- f) Të paguajnë kootizimin e anëtarësisë dhe të jenë të qëndrueshëm sa u takon detyrimeve të tyre financiare, siç përcaktohet në këtë statut, rregulloret ose me vendimin e Bordit të FMK-së;
- g) Të respektojnë Rregulloren e garave të përcaktuara nga UWW, FMK-së, dhe të sigurojnë që ato të respektohen gjithashtu nga anëtarët e tyre, mundësat-e dhe zyrtarët përmes një dispozite posaçme në statutet e tyre;
- h) Të miratojnë një klauzolë ligjore, statutore ku të specifikohet që çdo mosmarrëveshje e nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FMK-së mund të referohet në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme brenda FMK) vetëm në CAS në Kosovë, CAS në Lozanë e cila do të zgjidhë çështjen në mënyrë përfundimtare duke përjashtuar çdo gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, me përjashtim kur një gjë e tillë ndalohet shprehimisht nga legjislacioni i Republikës së Kosovës;
- i) Të administrojnë punët e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurojnë që punët e tyre të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në përputhje me nenin 22 të këtij statuti;
- j) Të sigurojnë që organet e tyre të zgjidhen ose të emërohen në përputhje me një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ;
- k) T'i komunikojnë FMK-së çdo ndryshim në statutin dhe rregulloret e saj, si dhe listën e zyrtarëve të saj, të cilët janë përfaqësues ligjorë me të drejtën për të lidhur marrëveshje ligjërish të detyrueshme me palë të treta;
- l) Të mos mbajnë asnjë marrëdhënie të natyrës sportive me subjektet që nuk njihen ose me anëtarët që janë pezulluar ose përjashtuar;
- m) Të respektojnë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sjelljes së mirë sportive si shprehje në gatat e ndershme përmes një dispozite statutore dhe të sigurojnë që këto parime të respektohen edhe nga anëtarët e tyre përmes një dispozite të posaçme statutore;
- n) Të respektojnë pikat e detyrueshme të specifikuara në nenin 14, paragrafi 2, të këtij statuti gjatë kohëzgjatjes së anëtarësisë së tyre;
- o) Të administrojnë një regjistër të anëtarëve, i cili të përditësohet rregullisht;
- p) Të pajtohen plotësisht me të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga statuti dhe rregulloret e tjera të UWW-s, dhe FMK-së.

2. Anëtarët duhet të integrojnë në statutin e tyre detyrimet e përmendura më sipër, për të qenë të zbatueshme për anëtarët e tyre.

3. Shkelja e detyrimeve të përmendura më sipër (p.sh. paragrafi 1 dhe 2) nga çdo anëtar mund të çojë në sanksionet e parashikuara në këtë statut.

4. Shkelja e paragrafit i/"j" më sipër mund të çojë në sanksione, edhe nëse ndikimi i palës së tretë nuk ishte për faj të anëtarit përkatës. Çdo anëtar i FMK-së është përgjegjës në raport me të, lidhur me çdo akt dhe të gjitha aktet e anëtarëve të organeve të tyre të shkaktuara nga neglizhenca ose sjellja e qëllimtë e pahijshme e këtyre anëtarëve.

5. Të respektojë **ligji nr. 06/l-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive**;



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

### NENI 18 PEZULLIMI

1. Kuvendi i Përgjithshme është përgjegjëse për pezullimin e një anëtari që shkel seriozisht dhe/ose në mënyrë të përsëritur detyrimet e tij si anëtar. Megjithatë, Bordi mund të pezullojë përkohësisht një anëtar të tillë me efekt të menjëhershëm. Ky vendim merret nga Bordi kur shumica (50%+1) e anëtarëve të tij është e pranishme dhe me një shumicë prej dy të tretave të votave të vlefshme. Pezullimi zgjat deri në Kuvendin e Përgjithshme të ardhshme, përveç nëse Bordi e ka revokuar atë ndërkohë.

2. Anëtari në fjalë ka të drejtën të dëgjohet nga Kuvendi i Përgjithshme/Bordin dhe mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit për pezullim. Përgjigja duhet t'i dërgohet anëtarëve bashkë me njoftimin për thirrjen e Kuvendi të Përgjithshme në përputhje me Nenin 33 paragrafi 4 dhe nenin 35 paragrafi 4 ose Bordi në përputhje me nenin 40 paragrafi 3.

3. Pezullimi i një anëtari nga Kuvendi i Përgjithshme ose Bordi konfirmohet në Kuvendin e Përgjithshme të ardhshme me praninë e shumicës (më shumë se 50%+1) së anëtarëve me të drejtë vote dhe me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura. Nëse nuk konfirmohet, pezullimi revokohet automatikisht.

4. Një anëtar i pezulluar i humbet të drejtat e tij të anëtarësisë. Anëtarët e tjerë nuk mund të kenë kontakte sportive me një anëtar të pezulluar. Komisioni i Disiplinës dhe Etikës mund të vendosë sanksione të mëtejshme.

5. Anëtarët që nuk marrin pjesë në aktivitetet sportive të FMK-së për 1 (vite) sezone pezullohen automatikisht nga votimi në Kuvendin e Përgjithshme dhe përfaqësuesit e tyre nuk do të zgjidhen/zgjidhen derisa të përmbushin detyrimet e tyre në këtë drejtim.

### NENI 19 PËRJASHTIMI

1. Kuvendi i Përgjithshme mund ta përjashtojë një anëtar nëse:

- Shkel rëndë dhe në mënyrë të përsëritur statutin, rregulloret ose vendimet e UWW-s dhe FMK-së;
- Nuk arrin të përmbushë kërkesat e anëtarësisimit të përcaktuara në këtë statut;
- Nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj FMK-së;
- Nëse vërtetohet se Anëtari ka pushuar së vepruari;
- Me fshirjen nga regjistri i Anëtarëve aktual;
- Me kërkesën personale me arsyetimin me shkrim;
- Me vendimin e Kuvendit të FMK-së;

2. Bordi ka të drejtë vetëm të propozojë përjashtimin e një anëtari.

3. Anëtari në fjalë mund të dëgjohet nga Kuvendi i Përgjithshme dhe gjithashtu mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit nga Bordi për përjashtimin e tij. Përgjigja do t'u dërgohet anëtarëve së bashku me thirrjen zyrtare të Kuvendit të Përgjithshme në përputhje me nenin 33, paragrafi 4 dhe nenin 35 paragrafi 4.

4. Prania e shumicës (më shumë se 50%+1) e delegatëve me të drejtë vote në Kuvendin e Përgjithshme është e nevojshme në mënyrë që përjashtimi të jetë i vlefshëm, dhe mocioni për përjashtim duhet të miratohet me shumicë prej dy të tretave të votave të vlefshme të delegatëve prezent.

5. Anëtari në fjalë nuk ka të drejtë vote në Kuvendin e Përgjithshme kur behet fjalë për përjashtimin e tij.





# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

### NENI 20 DORËHEQJA

1. Një anëtar mund të japë dorëheqjen me efekt nga fundi i një sezoni (d.m.th. 31 dhjetor). Njoftimi për dorëheqjen duhet të mbërrijë në zyrë te Sekretarit te Përgjithshëm jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të sezonit përkatës të mundjes.
2. Dorëheqja nuk është e vlefshme derisa anëtari që dëshiron të japë dorëheqjen të ketë përmbushur detyrimet e tij financiare ndaj FMK-së dhe anëtarëve të tjerë.

### NENI 21 SHPËRBËRJA

1. Nëse një anëtar shpërbëhet, qoftë vullnetarisht ose për shkaqe ligjore, anëtarësia e tij në FMK do të përfundojë me efekt të menjëhershëm në momentin që pushon personaliteti i tij juridik.
2. Organi ekzekutiv i anëtarit do të informojë Bordin për fillimin e procedurës së shpërbërjes.

### NENI 22 PAVARËSIA E ANËTARËVE DHE E ORGANEVE TË TJERA

1. Çdo anëtar e menaxhon punën e tij në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim të papërshtatshëm nga palët e treta.
2. Organet e anëtarëve do të zgjidhen ose emërohen. Statutet e anëtarëve duhet të parashikojnë një procedurë demokratike që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve.
3. Organet e anëtarëve që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 më sipër, edhe mbi bazë të përkohshme, nuk do të njihen nga FMK.
4. Vendimet e miratuara nga organet që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me paragrafin 2 më sipër nuk do të njihen nga FMK.

### NENI 23 STATUSI I KLUBEVE

1. Klubet të lidhura me FMK-në do të varen dhe njihen nga FMK.
2. Ky statut përcakton fushën e veprimit dhe të drejtat dhe detyrat e subjekteve të përmendura në paragrafin 1 më sipër. Statuti dhe rregulloret e tyre do të jenë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e statutit dhe rregulloreve të FMK-së. FMK do të ketë kompetencë ekskluzive dhe të padelegueshme për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me Referim, luftën kundër dopingut, parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në sport, regjistrimin e mundesave, licencimin e klubeve, vendosjen e masave disiplinore, përfshirë shkeljet e etikës, si dhe masat e kërkuara për të mbrojtur integritetin e garave, përfshirë luftën kundër shkeljeve të rregullores së garave apo këtij statuti.
3. Subjektet e përmendura në paragrafin 1 më sipër do të marrin të gjitha vendimet për çdo çështje në lidhje me anëtarësimin e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo person i jashtëm. Ky detyrim zbatohet pavarësisht nga struktura e tyre të organizimit.
4. Në çdo rast, asnjë person fizik ose juridik nuk do të ushtrojë kontroll mbi më shumë se një klub ose grup klubesh sa herë që mund të cenohet integriteti i ndonjë gare apo i FMK-se



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

### III. KRYETAR I NDERIT DHE ANËTARI I NDERIT NENI 24

#### KRYETAR I NDERIT DHE ANËTARI I NDERIT

1. Kuvendi i Përgjithshme i jep titullin "Kryetar Nderi" ose "Anëtar Nderi" çdo personi për shërbime dhe kontribut të shquara në sportin e mundjës. Në mënyrë që të miratohet kërkesa, kërkohet shumica e dy të tretave të votave të vlefshme.
2. Këto propozime bëhen nga Bordi . Kryetar nderi propozohet vetëm një individ i cili ka kryer më parë detyrën e kryetarit të FMK-së. Anëtar nderi mund të propozohet vetëm një individ i cili ka qenë më parë anëtar i organeve të FMK-së.
3. Kryetar i Nderit merr pjesë në Kuvendin e Përgjithshme si mysafir. Anëtar i Nderit mund të marrë pjesë në Kuvendin e Përgjithshme si mysafir.

#### NENI 25

#### ORGANET E FMK-SË

1. Kuvendi i Përgjithshme është organi më i lartë dhe legjislativ.
2. Bordi
3. Kryetari
4. Këshilli mbikëqyrës.

#### NENI 26

#### SHKARKIMI I NJË ANËTARI TË NJË ORGAN

1. Kuvendi i Përgjithshem mund të shkarkojë një anëtar të një organi. Bordi gjithashtu mund të shkarkojë një anëtar të një organi përkohësisht. Shkarkimi i përkohshëm i miratuar nga Bordi duhet të konfirmohet nga Kuvendi i Përgjithshem i ardhshëm, përveç se nëse Bordi e ka revokuar ndërkohë shkarkimin. Nëse Kuvendi i Përgjithshem i ardhshëm është e natyrës zgjedhore, anëtar i shkarkuar do të lejohet të jetë kandidat (me kusht që ai të përmbushë kriteret përkatëse të pranueshmërisë) në një bazë të kushtëzuar në varësi të vendimit përfundimtar të Kuvendit të Përgjithshem për shkarkimin e tij, vendim i cili do të merret para zgjedhjeve.
2. Kërkesa për shkarkim duhet të jetë e motivuar dhe do t'u dërgohet anëtarëve të Bordit dhe/ose anëtarëve të FMK-së së bashku me rendin e ditës përkatës.
3. Anëtar i organit në fjalë ka të drejtë të mbrohet përpara Bordit dhe/ose Kuvendit të Përgjithshem.
4. Kërkesa për shkarkimin do të vendoset me votim të fshehtë të Bordit dhe/ose Kuvendi i Përgjithshem. Që kërkesa të miratohet, kërkohet prania e shumicës (më shumë se 50%+1) së anëtarëve të Bordit dhe/ose anëtarëve dhe shumica e dy të tretave të votave të vlefshme të të pranishmëve.
5. Anëtar i shkarkuar (përkohësisht ose jo) lirohet nga funksionet e tij me efekt të menjëhershëm.

### KUVENDI I PERGJITHSHEM

#### NENI 27

#### PËRKUFIZIME DHE PËRBËRJA

1. Kuvendi i Përgjithshem është mbledhja ku anëtarët e FMK-së mbledhen rregullisht dhe përfaqësohen nga delegatë e klubeve që përmbushin pikat e këtij statuti. Kuvendi i Përgjithshme përfaqëson autoritetin më të lartë dhe legjislativ të FMK-së. Vetëm kur mbledhet sipas rregullave të parashikuara, Kuvendi i Përgjithshme ka të drejtë të marrë vendime.
2. Kuvendi i Përgjithshme konstituohet në përputhje me parimet e demokracisë përfaqësuese dhe merr parasysh rëndësinë e barazisë gjinore.
3. Kuvendi i Përgjithshme mund të jetë i zakonshme ose i jashtëzakonshme.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

4. Kuvendi i Përgjithshme kryesohet nga Kryetari, në përputhje me këtë statut, rregulloren e Kuvendit të Përgjithshme, si dhe çdo rregulloreje të zbatueshme.
5. Bordi mund të ftojë musafit për të marrë pjesë në Kuvendin e Përgjithshme, pa të drejtë për të debatuar ose për të votuar.
6. Kryetari i Nderit dhe/ose Anëtarët e Nderit marrin pjesë në Kuvend e Përgjithshme si mysafir, këta nuk mund të zgjedhën dhe të zgjidhin në organet e FMK.

### NENI 28

#### DELEGATËT DHE VOTAT

1. Kuvendi i Përgjithshme përbëhet nga anëtarë e deleguar të klubeve të ndarë si më poshtë:  
Delegatët duhet t'i përkasin klubit që ata përfaqësojnë dhe të emërohen ose zgjidhen nga organi i caktuar nga statuti i anëtarit brenda 20 ditëve nga data e Kuvendit të Përgjithshme. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje ta vërtetojnë këtë gjë. Delegimi i personave jo-anëtarë të klubeve nuk lejohet.  
Klubet të cilat marrin pjesë në të gjitha garat zyrtare të FMK-se përfaqësohen në Kuvendin e Federatës me nga 3 (delegat) delegatë, ku njëri nga ta duhet të jetë i gjinisë së kundërt.  
Klubet të cilat nuk marrin pjesë në të gjitha garat zyrtare të FMK-se përfaqësohen në kuvendin e përgjithshëm me 2 (dy) delegat, ku njëri nga ta duhet të jetë i gjinisë së kundërt.  
Shoqatat të pranuar në FMK përfaqësohen në kuvendin e përgjithshëm me një delegat.  
Klubet e reja të cilat anëtarësohen në FMK kanë të drejtë vote pas katër vite pjesëmarrje në garat zyrtare të FMK-se.  
Kuvendi në baze të statutit njëj garat zyrtare të FMK-se, që përfshijn : Kampionati i Kosovës U-15, U-17, U-20, U-23 dhe Senior.  
Delegatët e klubeve duhet të jenë të moshës madhore nga 18-65 vjeçare.  
Delegatët duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
2. Komisioni i Verifikimit do të përcaktojë numrin e delegatëve të klubeve sipas këtij statuti.
3. Secili delegat ka një votë në Kuvendin e Përgjithshme. Vetëm delegatët e pranishëm kanë të drejtë vote. Votimi me autorizim ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.
4. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv dhe të Sekretariatit të Përgjithshëm marrin pjesë në Kuvendin e Përgjithshme pa të drejtë vote. Gjatë mandatit të tyre, anëtarët e Bordit Ekzekutiv nuk mund të emërohen si delegatë në Kuvendin e Përgjithshme.

### NENI 29

#### FUSHAT E KOMPETENCAVE

Kuvendi i Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

1. Të miratojë ose ndryshojë këtë statut;
2. Të miratojë ose ndryshojë rregulloren e kuvendit të përgjithshme;
3. Të miratojë ose ndryshojë rregulloren e këshillit mbikëqyrës;
- b) Të caktojë një anëtarë për të kontrolluar procesverbalet dhe për të shqyrtuar procesverbalet e mbledhjes së fundit;
- c) Të zgjedhë kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e tjerë të Bordit;
- d) Të zgjedhë anëtarët e këshillit mbikëqyrës;
- e) Të emërojë komisionin zgjedhor për të numëruar votat dhe për të ndihmuar sekretarin e përgjithshëm për shpërndarjen e fletëve të votimit për zgjedhjet;
- f) Të miratojë pasqyrat vjetore financiare të audituara, përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

raportin financiar vjetor;

- g) Të miratojë planin financiar të FMK-së për vitin pasardhës;
- h) Të miratojë raportit e punës, i cili përmban aktivitetet e FMK-së që nga kuvendi i përgjithshme i kaluar, raportin e punës për vitin pasardhës, si dhe raportet e rekomandimet tjera të Bordit;
- i) Të përcaktojë pranimet e anëtarësisë me propozim të Bordit;
- j) Të japë titullin "president Nderi" ose "anëtar Nderi", me propozimin e Bordit;
- k) Të pranojë, të pezullojë ose përjashtojë një anëtar;
- l) Të shkarkoj kryetarin ,nënkryetarin dhe anëtarët e tjerë të Bordit apo Këshillin Mbikëqyrës që zgjedhën në kuvend;
- m) Të shpërbëjë FMK-në dhe të vendosë për përdorimin e asetëve të saj;
- n) Të miratojë vendimet me kërkesë të një anëtari në përputhje me këtë statut ose të miratojë ndonjë vendim që i është besuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me këtë statut.
- o) Vendos mbi faljen e dënimeve,
- p) Mënyra e punës së Kuvendit rregullohet me Rregulloren Kuvndit .

### NENI 30 KUORUMI

1. Vendimet e miratuara nga kuvendi i përgjithshme do të jenë të vlefshme vetëm nëse në mbledhje, është e pranishme shumica (më shumë se 50%+1votë) e delegatëve me të drejtë vote.
2. Nëse kuorumi nuk arrihet, zhvillohet një kuvend te përgjithshme e dytë me të njëjtën rend dite brenda 7 ditëve.
3. Kuorumi nuk kërkohet për mbledhjen e dytë të Kuvendit të përgjithshme përveç se nëse në rendin e ditës është e parashikuar një nga çështjet e mëposhtme:
  - a) një ndryshim të këtij statuti apo rregullores së kuvendi të përgjithshme, apo rregulloren e komisionit mbikëqyrës;
  - b) zgjedhja e kryetarit ose e anëtarëve të tjerë të Bordit ;
  - c) zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarit ose anëtarëve të komisioneve të pavarura;
  - d) shkarkimin e një anëtari të një organi të FMK-së;
  - e) pezullimin ose përjashtimin e një anëtari;
  - f) shpërbërjen e FMK-së. për vendimmarrjen për pikat e sipërpërmendura, është e nevojshme shumica e përcaktuar në paragrafin 1 më sipër.
4. Nga momenti që deklarohet se asambleja e përgjithshme është thirrur dhe mbledhur në përputhje me këtë statut, kuorumi nuk do të ndikohet nga delegatët që largohen nga mbledhja.

### NENI 31 VENDIMET

1. Vendimet që hidhen në votë, do të merren me anë të ngritjes së duarve ose me anë të numërimit elektronik, përveçse nëse një e treta e anëtarëve kërkon që të bëhet votim i fshehtë. Nëse ngritja e duarve nuk çon në një shumicë të qartë në favor të një vendimi, votimi do të bëhet duke thirrur listën e delegatëve në rend alfabetik.
2. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë statut, shumica (më shumë se 50%+1votë) e votave të vlefshme të dhëna në favor, është e mjaftueshme që një vendim të merret. fletët bosh të votimit, votat e pavlefshme



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

ose votat elektronike të manipuluar në çdo mënyrë, si dhe abstenimet nuk merren në konsideratë kur llogaritet shumica.

## NENI 32 ZGJEDHJET

1. Zgjedhjet zhvillohen me votim të fshehtë. Megjithatë, nëse numri i kandidatëve është i barabartë me numrin e pozicioneve të lira, për të cilat mbahen zgjedhjet, kuvendi i përgjithshme mund të vendosë të procedojë ndryshe.
2. Zgjedhjet do të kryhen në përputhje me rregulloren e kuvendit të përgjithshme të FMK-së dhe do të mbikëqyren nga Komisioni i Verifikimit.
3. Zgjedhjet për pozicionet brenda Bordit do të bëhen sipas pozicionit (së pari kryetari, nënkryetari dhe më pas anëtarët e tjerë të Bordit), të paktën një pozicion do të rezervohet për kandidatë femër.
4. Kandidatët për kryetar, nënkryetar, anëtarët Bordit duhet të jenë  
psh: kryetar, nënkryetar, sekretar, anëtarë aktiv në kryesinë atij klubi që i propozon, për t'u marrë në konsideratë nga Kuvendi i përgjithshme.
5. Klubet me 3 delegat mund të propozojë një kandidat mashkull dhe një kandidatë femër në zgjedhje për pozicionet brenda bordit duke përfshirë të gjitha pozitat (kryetarin, nënkryetar dhe anëtarët e Bordit), asnjë klubi si lejohet të ketë 3 kandidat-e për pozicione brenda bordit, një kandidat-e nuk mund të kandidojë për dy pozita brenda bordit në zgjedhje.
  - a) Klubet me 2 delegat mund të propozojë një kandidat-e mashkull apo femër në zgjedhje për pozicionet brenda bordit duke përfshirë pozitën (anëtarë të Bordit).
  - b) Shoqatat me 1 delegat mund të propozojë një kandidat-e mashkull apo femër në zgjedhje për (anëtarët të Bordit).
6. Kandidatët për kryetar, nënkryetar propozohen nga klubet të cilat i kanë nga 3 delegat në kuvendin e FMK-së.
7. Për zgjedhjen e kryetarit, shumica e (50% +1 votë) të votave të vlefshme janë të nevojshme në raundin e parë zgjidhet Kryetar. Në rast se asnjë kandidat nuk e arrin këtë shumicë, zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve midis dy kandidatëve që kanë marrë shumicën e votave të vlefshme të dhëna në raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr shumicën e votave të vlefshme të dhëna, zgjidhet kryetar. Në rast barazimi, do të zhvillohet raundi i tretë, ku do të zbatohet e njëjta shumicë. Në rast se edhe raundi i tretë përfundon me barazim, presidenti caktohet me short, i cili hidhet nga sekretari i përgjithshëm dhe monitorohet nga Komisioni i Verifikimit.
8. Për zgjedhjen e nënkryetarit, anëtarëve të tjerë të Bordit, secili anëtar mund të votojë për aq kandidatë sa janë pozicionet e lira ose më pak. Nëse nuk ka asnjë grua kandidatë për Bordin, vendi mbetet vakant deri në asamblenë e përgjithshme të radhës ku një kandidatë grua do të zgjidhet për pjesën e mbetur të mandatit. Një kandidat zgjidhet nënkryetar, anëtar i Bordit nëse merr shumicën absolute (50% +1 votë) në raundin e parë. Nëse nuk ka kandidatë të mjaftueshëm që mbështeten me shumicë absolute, për të mbushur vendet vakante mbahet një raund i dytë në të cilin një shumicë e thjeshtë (numri i më i madh i votave) është i mjaftueshëm për një kandidat që të zgjidhet. Në rast barazimi, rezultati përcaktohet me short i cili hidhet nga sekretari i përgjithshëm dhe monitorohet nga Komisioni i Verifikimit.
9. Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës zgjedhjen, kandidati (ose kandidatët) që merr (ose marrin) më shumë vota, shpallen fitues.





# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

10. Për të qenë kandidat për kryetar, kandidati ose kandidatja duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- Të jetë shtetas Kosovar me banim të përhershëm në Kosovë;
  - Të mos jetë dënuar për ndonjë veprën penale mbi 6 muaj burgim efektiv ashtu siç përcaktohet me kodin penal të Republikës së Kosovës dhe kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës .
  - Të jetë nën moshën 65 vjeç në datën e mbajtjes së kuvendit të përgjithshme Zgjedhore;
  - Të jetë i kualifikuar për rolin;
  - Nuk duhet të jenë apo të kenë qenë, deputetë, kandidatë për deputetë, anëtarë të organeve drejtuese në ndonjë parti politike, ose funksionar politik në 4 vitet e fundit.
  - Duhet te flas gjuhen angleze ose franceze (gjuhet zyrtare te UWW-se).
  - Duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e lartë;
  - Preferohet të jetë veprimtar i dalluar sportit të Mundjes qoftë me rezultate në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
11. Për të qenë kandidat për nënkryetar, anëtarë të tjerë të Bordit, anëtarë te këshillit mbikëqyrës kandidati ose kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- Të jetë shtetas Kosovar me banim të përhershëm në Kosovë;
  - Të mos jetë dënuar për ndonjë veprën penale mbi 6 muaj burgim efektiv ashtu siç përcaktohet me kodin penal të Republikës së Kosovës dhe kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës .
  - Të jetë nën moshën 65 vjeç në datën e mbajtjes së kuvendit të përgjithshme Zgjedhore;
  - Të jetë i kualifikuar për rolin;
  - Nuk duhet të jenë apo të kenë qenë, deputetë, kandidatë për deputetë, anëtarë të organeve drejtuese në ndonjë parti politike, ose funksionar politik në 4 vitet e fundit.
  - Preferohet te flas gjuhen angleze ose franceze.
- g) Preferohet të jetë veprimtar i dalluar sportit të Mundjes qoftë me rezultate në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
12. Fletët bosh të votimit, votat e pavlefshme ose votat elektronike të manipuluar në çdo mënyrë, si dhe abstenimet nuk merren në konsiderate kur llogaritet shumica.
13. Kandidaturat për cilindo nga pozicionet e Bordit do të dërgohen te sekretari i përgjithshëm të paktën 14 ditë para kuvendit të përgjithshme Zgjedhore përkatëse. lista zyrtare e kandidatëve duhet t' u kalohet anëtarëve të FMK-së të paktën 7 ditë para kuvendit të përgjithshme ku do të zgjidhet Bordi ekzekutiv. Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen gjithashtu kur zgjedhjet zhvillohen gjatë një kuvendi të përgjithshme të Jashtëzakonshme.

### NENI 33

#### KUVENDI I PËRGJITHSHME I ZAKONSHME

- Kuvendi i Përgjithshme i zakonshme mbahet çdo vit jo më vonë se data 28 shkurt.
- Bordi përcakton vendin dhe datën e Kuvendit të Përgjithshme. Anëtarët njoftohen me shkrim të paktën 14 ditë përpara për mbledhjen e Kuvendit të Përgjithshme.
- Çdo propozim që një anëtar dëshiron t' i paraqesë Kuvendit të Përgjithshme, i dërgohet me shkrim Sekretari i Përgjithshëm, me një shpjegim të shkurtër, të paktën 10 ditë para datës së Kuvendit të Përgjithshme. Bordi vendos a duhet ty hyj aj propozim ne rendin e ditës apo jo.
- Sekretari i Përgjithshëm, të paktën 7 ditë para datës së Kuvendit të Përgjithshme u dërgon anëtarëve me shkrim rendin përfundimtar të ditës, raportin e punës , raportin financiar, raportin e auditorit të jashtëm dhe çdo dokument tjetër të lidhur me rendin e ditës dhe me kompetencat e Kuvendit të Përgjithshme.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

### NENI 34

#### RENDI I DITËS I KUVENDIT TË PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME

1. Sekretari i Përgjithshëm harton rendin e ditës në bazë të propozimeve të Bordit dhe anëtarëve.
2. Rendi i ditës së Kuvendit të Përgjithshme përmban çështjet e mëposhtme të detyrueshme (në rend kronologjik):
  - a) Deklarimin e thirrjes së Kuvendit të Përgjithshme dhe përbërjen e saj në përputhje me këtë statut;
  - b) Miratimin e rendit të ditës;
  - c) Fjalimin e Kryetarit;
  - d) Emërimin e një anëtari për të kontrolluar procesverbalet;
  - e) Emërimin e komisionit të verifikimit prej 3 anëtarëve;
  - f) Pezullimin ose përjashtimin e anëtarëve (nëse aplikohet);
  - g) Miratimin e procesverbalit të Kuvendit të Përgjithshme;
  - h) Miratimin e Raportin e Punës(që përmban aktivitetet që nga Kuvendi e Përgjithshme e mëparshme),dhe raportin e punës për vitin pasardhës,
  - i) Miratimi i planit financiar;
  - j) Miratimin e pasqyrave financiare të audituara nga auditorit të pavarur të jashtëm ;
  - f)Të miratojë pasqyrat vjetore financiare të audituara, përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin financiar vjetor;
  - k) Të miratojë planin financiar të FMK-së për vitin pasardhës;
  - l) Votimin për propozimet për ndryshime në këtë statut dhe/ ose rregulloren e Kuvendi i Përgjithshme, komisionit mbikëqyrës(nëse është e nevojshme);
  - m) Diskutimin e propozimeve të paraqitura nga Bordi ose anëtarët në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 32, paragrafi 3 të këtij Statuti;
  - n) Shkarkimin e një anëtari të një organi të FMK-së (nëse është e zbatueshme);
  - o) Zgjedhjen e Kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Bordit (nëse zbatohet);
  - p) Zgjedhjen e anëtarëve te komisionit mbikëqyrës (nëse zbatohet);
  - q) Pranimin për anëtarësim (nëse është e nevojshme);
3. Kuvendi i Përgjithshme nuk merr vendim për pikat të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
4. Rendi i ditës i Kuvendit të Përgjithshme të Zakonshme mund të ndryshohet me kusht që dy të tretat e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote në Kuvend te Përgjithshme të bien dakord me një kërkesë të tillë.

### NENI 35

#### KUVENDI I PËRGJITHSHME I JASHTËZAKONSHME

1. Bordi mund të thërrasë Kuvendin e Përgjithshme të Jashtëzakonshme në çdo kohë nëse këtë e kërkojnë (50% +1 votë) apo 4 anëtare te bordit .
2. Bordi e mbledh Kuvendin e Përgjithshme të Jashtëzakonshme nëse merr shumicën absolute (50% +1 votë) anëtarëve me të drejtë vote të FMK-së bëjnë një kërkesë të tillë me shkrim siç e përshe ky statut. Kërkesa përcakton pikat që do të përfshihen në rendin e ditës. Kuvendi i Përgjithshme e Jashtëzakonshme do të mbahet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim. Nëse nuk thirret Kuvendi i Përgjithshme e Jashtëzakonshme, anëtarët që e kërkuan atë mund të mbledhin vetë Kuvendin e Përgjithshme e Jashtëzakonshme. Duke vepruar kështu, ata informojnë të gjithë anëtarët e FMK-së dhe Bordin për datën dhe vendndodhjen e Kuvendit të Përgjithshme të Jashtëzakonshme, së bashku me pikat që do të përfshihen në rendin e ditës në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.
3. Të gjithë anëtarët e FMK do të njoftohen për vendin dhe datën të paktën 10 ditë para datës së Kuvendit të Përgjithshme të Jashtëzakonshme.
4. Kur kuvendi i Përgjithshme e Jashtëzakonshme thirret me iniciativën e Bordit, ai duhet të hartojë rendin e ditës. Kur thirret me kërkesë të delegatëve te klubeve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga vetë



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

delegatet. Anëtarët që kanë thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme, të paktën 10 ditë para datës së Kuvendit të Përgjithshme të Jashtëzakonshme duhet t'u dërgojnë anëtarëve dhe Bordit rendin e ditës dhe çdo dokument tjetër që lidhet me rendin e ditës.

5. Rendi i ditës i Kuvendit të Përgjithshme të Jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet.

### NENI 36

#### **NDRYSHIMET NË STATUT DHE RREGULLOREN E KUVENDIT TË PËRGJITHSHME SI DHE RREGULLOREN E KESHILLIT MBIKQYRES**

1. Kuvendi i Përgjithshme është përgjegjëse për ndryshimin e këtij statuti dhe Rregullores së Kuvendit të Përgjithshme, Rregulloren e Këshillit mbikëqyrës.
2. Çdo propozim për ndryshim të këtij statuti dhe Rregullores së Kuvendit të Përgjithshme dhe Rregulloren e Këshillit mbikëqyrës duhet të paraqitet me shkrim me një shpjegim të shkurtër të Sekretaria i Përgjithshëm nga një anëtar ose nga Bordi. Është i vlefshëm edhe propozimi i paraqitur nga delegatët që përfaqësojnë një anëtar, me kusht që të jetë mbështetur me shkrim nga të paktën dy delegatë të tjerë që përfaqësojnë anëtarët.
3. Në mënyrë që votimi mbi një ndryshim të statudit dhe/ose të Rregullores së Kuvendit të Përgjithshme dhe Rregullores së Këshillit mbikëqyrës të jetë i vlefshëm, duhet të jetë e pranishme shumica (më shumë se 50%+1) e anëtarëve me të drejtë vote.
4. Propozimi për një ndryshim të këtij statuti dhe të Rregullores së Kuvendit të Përgjithshme dhe Rregulloren e Këshillit mbikëqyrës do të miratohet vetëm nëse dy të tretat e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, votojnë në favor të ndryshimeve të propozuara.

### NENI 37

#### **PROCESVERBALET**

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të Kuvendit të Përgjithshme.
2. Anëtarët e caktuar për të verifikuar procesverbalet duhet ta bëjnë këtë në mënyrë që procesverbalet t'u dërgohen anëtarëve brenda 60 ditëve nga Kuvendi i Përgjithshme. Procesverbali do të konsiderohet i aprovuar nëse, brenda 10 ditëve nga dërgimi i tij, nuk paraqiten kundërshtime me shkrim të Sekretaria i Përgjithshëm. Në rast të marrjes së ndonjë kundërshtimi, procesverbali vendoset për shqyrtim në rendin e ditës të Kuvendin e Përgjithshme të Zakonshme pasardhëse.

### NENI 38

#### **DATA E HYRJES NË FUQI TË VENDIMEVE**

Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Përgjithshme do të hyjnë në fuqi menjëherë pas përfundimit të Kuvendit të Përgjithshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë statut, ose nëse Kuvendi i Përgjithshme përcakton një datë tjetër për hyrjen në fuqi të një vendimi.

### **B. BORDI**

#### **NENI 39**

#### **PËRBËRJA**

1. Bordi përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, ku të paktën një prej të cilëve janë femra, me përbërjen e mëposhtme:
  - a) 1 Kryetari;
  - b) 2 Nënkyetari;
  - c) 6 Anëtarë.Kryetarin, dy nënkryetaret dhe tre anëtar i zgjedh Kuvendi, ndërsa tre anëtar i zgjedh Kryetari.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

2. Të gjithë anëtarët e Bordit i nënshtrohen kontrollit të integritetit, i cili kryhet nga Komisioni i Verifikimit, para zgjedhjes ose rizgjedhjes së tyre.
3. Kryetari ka mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje .
4. Nënkyetari dhe anëtarët e tjerë të Bordit kanë mandat 4-vjeçar me mundësi rizgjedhje. Mandatet do të ndjekin të njëjtin cikël zgjedhor. Mandatet e tyre fillojnë menjëherë pas përfundimit të Kuvendit të Përgjithshme që i ka zgjedhur ata dhe përfundojnë në fund të Kuvendit të Përgjithshme që zgjedh pasardhësit e tyre.
5. Të gjithë anëtarët e Bordit duhet të plotësojnë kushtet paraprake të parashikuara në nenin 32, paragrafi 11 i këtij statuti.
6. Një anëtar i Bordit Ekzekutiv nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i një komisioni të pavarur dhe nuk mund të emërohet/zgjidhet si delegat që përfaqëson një anëtar në Kuvendin e Përgjithshme.
7. Nëse një pozicion ose deri në 50% të pozicioneve të Bordit janë vakante, ata/o do të zgjedhën në Kuvendin e radhës, zëvendësuesit e pozicioneve përkatëse zgjedhën për periudhën e mbetur të ushtrimit të detyrës .
8. Nëse më shumë se 50% të pozicioneve të Bordit janë vakante, anëtarët e mbetur do të thërrasin një Kuvend të Përgjithshme e Jashtëzakonshme brenda periudhës së parashikuar kohore të parashikuar në Nenin 35, paragrafi 2 i Statutit. Në rast se, brenda 1 (një) jave nga kalimi i afatit, anëtarët e mbetur nuk e thërrasin Asamblenë e përgjithshme, atë e thërret Sekretari i Përgjithshëm.
9. Çdo pozicion brenda Bordit duke përfshirë kryetarin ,nënkyetarin, anëtarët e Bordit mund ti ndërpriten edhe para kalimit të 4 (katër) viteve ose konsiderohet vakant në rast :
  - a) Vdekje
  - b) Dhënie Dorëheqjeje
  - c) Ose nëse anëtari në fjalë pëson një pengesë të përhershme për kryerjen e funksionit;
  - d) Ndërron ose e humb shtetësinë;
  - e) Votimit të mosbesimit ndaj tij të miratuar nga Kuvendi apo të ndonjë situatë që nuk mund të vazhdojë më të kryej detyrën siç e parasheh ky statut;
  - f) Mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale;
  - g) Një Anëtar nëse dënohet ndonjëherë me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë veprën penale mbi 6 muaj burgim efektiv ashtu siç përcaktohet me kodin penal të Republikës së Kosovës dhe kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës personit në fjale i ndërpriten mandati automatikisht, nuk ka të drejtë të kandidohet për asnjë pozitë në kuadër të organeve të FMK-së

## NENI 40 MBLEDHJET

1. Bordi mblidhet të paktën 4 (herë) herë në vit.
2. Kryetari thërret mbledhjet e Bordit .
  - a) Nëse të paktën 5 (pese) anëtarë të Bordit kërkojnë mbledhjen e Bordit, Kryetari e thërret atë në mënyrë që takimi të mbahet brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës. Nëse Kryetari nuk e thërret mbledhjen e kërkuar brenda afatit të sipërpërmendur, mbledhja do të thirret nga nënkryetari apo vetë anëtarët e tjerë të Bordit , por ata duhet t'ua dërgojnë rendin e ditës të gjithë anëtarëve të Bordit të paktën 5 (pesë) ditë para mbledhjes, në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.
3. Kryetari, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, harton rendin e ditës duke njoftuar anëtarët të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes. Secili anëtar i Bordit ka të drejtë të propozojë çështje për t'u përfshirë në rendin e ditës pranë Sekretarisë së Përgjithshme të paktën 4 (katër) ditë para mbledhjes. Rendi përfundimtar i ditës dhe materialet përkatëse duhet t'u dërgohet anëtarëve të Bordit të paktën tre ditë përpara mbledhjes.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

4. Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Bordit dhe pa të drejtë vote. Nëse Sekretari i Përgjithshëm nuk është në gjendje të marrë pjesë në një mbledhje, ai mund të emërojë një përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhje në emër të tij, me kusht që të miratohet nga Bordi.
5. Mbledhjet e Bordit mbahen me dyer të mbyllura. Sidoqoftë, Bordi mund të ftojë palët e treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk do të kenë të drejtë vote dhe mund të shprehin opinione vetëm me lejen e Bordit.
6. Kryetari gjithashtu mund të thërrasë Bordin në mënyrë urgjente për të trajtuar çdo çështje që kërkon zgjidhje të menjëhershme midis dy takimeve të Bordit. Nëse anëtarët e Bordit nuk mund të takohen fizikisht dhe i nënshtrohen dispozitave të nenit 41, paragrafi 1 dhe 2, vendimet mund të merren përmes mjeteve të tjera moderne të komunikimit.

### NENI 41

#### KOMPETENCAT E BORDIT

Bordi ka kompetencat e mëposhtme:

1. Të miratojë vendimet për të gjitha çështjet të cilat nuk hyjnë në kompetencat e Kuvendit të Përgjithshme ose nuk janë të rezervuara për organe të tjera të FMK-së në bazë të këtij statuti;
2. Të sigurojë zbatimin e këtij statuti dhe miratimin e vendimeve ekzekutive të kërkuara për zbatimin e tyre, përfshirë miratimin dhe nxjerrjen e Rregullores së Organizimit të Brendshëm të FMK-së, rregulloret për organizimin e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme ose rregulloreve të tjera përkatëse;
3. Të administrojë dhe të drejtojë aktivitetet e FMK-së në përputhje me këtë statut;
4. Të përgatisë dhe rishikojë buxhetin, duke përfshirë përdorimin e fondeve për shpenzime të papritura në buxhet që nuk tejkalojnë masën 20% të buxhetit vjetor të FMK-së, të miratuar në Kuvendin e Përgjithshme më të fundit;
5. Të përgatisë, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, dhe të thërrasë Kuvendin e Përgjithshme të Zakonshme e të Jashtëzakonshme;
6. Të emërojë Sekretarin e Përgjithshëm, me propozim të Kryetarit;
7. Të emërojë kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
8. Të vendosë për krijimin e komisioneve të posaçme nëse është e nevojshme në çdo kohë;
9. Të zgjedh audituesin e pavarur dhe të jashtëm;
10. Miraton kalendarin e garave;
11. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes të drejtat dhe përgjegjësit dhe çështjet tjera me rendësi për punën e bordit rregullohen me rregulloren e Bordit FMK.;
12. Të miratojë dhe të nxjerrë rregullore;
  - a) Rregulloren e bordin e FMK;
  - b) Rregulloren disiplinore;
  - c) Rregulloren e garave;
  - d) Rregulloren për Regjitrimit/licencimin e klubeve;
  - e) Rregulloren për kalimin e mundesave nga klubi në klub;
  - f) Rregulloren e Atni-Dopingut;
  - g) Rregulloren për shpalljen e laureatëve të vitit;
  - h) Rregulloren për Kodin Etik ;
  - i) Organizimin e garave të organizuara nga FMK,
  - j) Të nxjerr dhe të aprovon rregullore tjera që janë në kompetencë të bordit;
  - k) Bordi miraton rregulloren për klasifikimin e informacioneve dhe obligohet Sekretari i Përgjithshëm të ofrojë transparencën, publikimin dhe qasjen e tyre sipas kësaj rregullore.
  - l) Bordi miraton rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe obligohet Sekretari i Përgjithshëm të aplikojë këtë rregullore.
13. Të emërojë ose shkarkojë trajnerët e reprezentacionit.





# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

14. Të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FMK-së për zgjedhje/emërim në organe të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
  15. Të shkarkojë një anëtar të një organi, ose të pezullojë një anëtar të FMK-së provizorisht deri në Kuvendin e Përgjithshme të ardhshme;
  16. Të propozojë kandidatura të përshtatshme për titullin "President Nderi" dhe "Anëtar Nderi" të FMK-së;
  17. Miraton plotësim ndryshimet e Statutit, Rregulloren e Kuvendit, Rregulloren e këshillit mbikëqyrës dhe i dërgon ato në kuvend për tu aprovuar;
  18. Vendosë për pranimin e punëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre;
  19. Cakton lartësinë e mëditjeve për zyrtarë të garave, refer, mbledhjet e bordit, mbledhjet e komisioneve të FMK ,udhëtime zyrtare jashtë vendit, udhëtime në gara jashtë vendit , Kongrest e Federatës Botërore edhe apo Evropiane të Mundjës, udhëtime ne seminare ndërkombëtare ,udhëtime ne trajnime jashtë vendit etj.
  20. Miraton planin strategjik të FMK-së për një cikël Olimpik.
  21. Përfaqëson FMK në të gjitha çështjet juridike përmes zyrtarëve të saj apo palëve të treta;
  22. Shqyrton të gjitha aplikimet për anëtarësim të ri bazuar në raportin e sekretarit dhe komisionit për regjistrim dhe të bëjë rekomandime për pranimin e tyre në Kuvend;
  23. Sipas vlerësimit monitoron kuvendet zgjedhore të klubeve te regjistruar në FMK;
  24. FMK-ja në baza vjetore shpall Laureatët e Vitit.
- a) Bordi përcakton në bazë të mundësive buxhetore nivelin apo llojin e shpërblimit për tu ndarë Laureatëve te Vitit në FMK.

### NENI 42

#### VENDIMET

1. Bordi konsiderohet i mbledhur rregullisht vetëm nëse janë të pranishëm të paktën 5 (pese) nga 9 anëtarët e tij.
2. Bordi merr vendime me shumicën absolute (50% + 1 votë) të anëtarëve të Bordit të pranishëm dhe të votave të vlefshme. Votimi me autorizim ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.
3. Çdo anëtar i Bordit duhet të tërhiqet nga debati dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku ose mundësia e konfliktit të interesit.
4. Vendimet e marra regjistrohen në procesverbal.
5. Vendimet e marra nga Bordi hyjnë në fuqi menjëherë, përveç nëse Bordi vendos ndryshe.

### C. KRYETARI

#### NENI 43

#### KRYETARI

1. Kryetari është kryesisht përgjegjës për:
  - a) Thirrjen e mbledhjeve të Kuvendit të Përgjithshme dhe Bordit;
  - b) Zbatimin e vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Përgjithshme dhe Bordi përmes Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - c) Sigurimin e funksionimit efektiv të organeve në mënyrë që ato të arrijnë objektivat e përshkruar në këtë statut;
  - e) Marrëdhëniet midis FMK-së dhe anëtarëve të saj, Federatës Botërore të Mundjes, Federatës Evropiane të Mundjes, Komitetit Olimpik të Kosovës ,Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Departamentit të Sportit etj.
2. Kryetari mund t'i propozojë Bordit emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Kryetari kryeson Kuvenin e Përgjithshme dhe mbledhjet e Bordit dhe ato komisione në të cilat ai është emëruar kryetar.
4. Kryetari do të ketë 1 (një) votë të zakonshme në Bord. Në rast barazie të votave, Kryetari ka votë vendimtare.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS

## KOSOVA WRESTLING FEDERATION

### SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

5. Nëse Kryetari mungon ose nuk është i disponueshëm, apo për ndonjë arsye tjetër, ai zëvendësohet nga nënkryetari.
6. Nëse pozicioni i kryetarit bëhet vakant në kuptimin e nenit 39, paragrafi 8, të këtij statuti, ai zëvendësohet nga nënkryetari deri në Kuvendin e Përgjithshme të ardhshme. Ky Kuvendi i Përgjithshme do të zgjedhë Kryetarin e ri për periudhën e mbetur të mandatit.
7. Përfaqëson Bordin dhe FMK në ngjarjet ndërkombëtare,
8. Nënshkruan vendimet e Bordit dhe të Kuvendit;
9. Urdhëron ekzekutimin e planit financiar,
10. Merr vendime në rrethana të jashtëzakonshme, kur Bordi nuk mund të mbledhet dhe informon këto organe, sa më shpejt të jetë e mundur,
11. Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga ky statut dhe vendimet e Kuvendit dhe Bordit;
12. Administrimin dhe mbajtjen e llogarive

#### NENI 44

#### PËRFAQËSIMI DHE NËNSHKRIMI

Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm, ose Nënkryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm, mund të nënshkruajnë bashkërisht në emër të FMK-së, përfaqësojnë, propozohen për organe drejtuese në kuvendet e Federatës Botërore, Evropiane, KOK, përfaqësojnë FMK në takime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, gara vendore dhe ndërkombëtare etj.

#### D. SEKRETARI I PËRGJITHSHË

#### NENI 45

#### SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sekretariati i Përgjithshëm është organ ekzekutiv, operacional dhe administrativ dhe e kryen detyrat në bazë të këtij statuti, vendimeve të bordit, vendimeve të kuvendit, duhet të respektojë rregulloret e brendshme të FMK-së dhe do të përmbushin detyrat e caktuara në mirëbesim.

#### NENI 46

#### SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

1. Sekretari i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i FMK-së. Në mungesë të tij, ai emëron një zëvendësues nga Sekretariati i Përgjithshëm.
2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga bordi, me propozim të kryetarit, në bazë të një marrëveshjeje të rregulluar nga e drejta private dhe duhet të ketë kualifikimet dhe/ose përvojën e nevojshme profesionale si sekretar. Bordi është gjithashtu organi përgjegjës për shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për:
  - a) Meret me zbatimin e vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Përgjithshme dhe Bordit në përputhje me këtë statut;
  - b) Merr pjesë në Kuvendin e Përgjithshme dhe mbledhjet e Bordit dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohshme pa të drejtë vote;
  - c) Meret me organizimin e Kuvendit të Përgjithshme dhe mbledhjeve të Bordit, komisioneve dhe organeve të tjera të FMK;
  - d) Përpilimin e procesverbalit për mbledhjet e Kuvendit të Përgjithshme, Bordit dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
  - e) Administrimin dhe mbajtjen e llogarive;
  - f) korrespondencën;
  - g) Realizon bashkëpunimin të mirë me bordin e FMK, klubet, komisionet, Ministrinë për Kulturë Rini dhe Sport, Departamentin e Sportit, KOK-un, UWW-s, etj;
  - h) Merret me organizimin e zyres së FMK;



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

- i) Merret me emërimin dhe shkarkimin e personelit që punojnë në zyrën e FMK;
- j) Siguron mbështetje logjistike dhe operative për zgjedhjet për Komisionin e Verifikimit.
4. Se bashku me komisionin ligjor udhëheq me draftimin e akteve normative brenda FMK (në përputhje me statutin e FMK. Ligjin për sport, Ligjin për OJQ, , si dhe nevojave që dalin nga harmonizimi i Federatës Botërore apo Evropiane të Mundjes );
5. Mbanë kontakte me mjetet e informimit,
6. I propozon Bordit, profilin e bashkëpunëtorëve profesional-administrativë,
7. Interpretin aktet e brendshme normative të Federatës,
8. Ekzekutimin dhe monitorimin e planit financiar të FMK-së në bazë të kërkesave dhe vendimeve të Bordit Ekzekutiv;
9. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për dorëzim ose aplikim në Departamentin të Sportit në MKRS me qëllim të raportimit dhe mbylljes e hapjes së kisteve kuartale;
10. Për punën dhe performancën e tij Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet Bordit të FMK.
10. Sekretari i Përgjithshëm themelon marrëdhënie të punës me Federatën në bazë të Ligjit mbi Marrëdhënie të Punës. Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij nga bordi i FMK (më shumë se 50%+1) e te gjithë anëtarëve të bordit të FMK.

### NENI 47

#### KËSHILLI MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës siguron se kontabiliteti financiar është i plotë dhe i besueshëm, dhe rishikon pasqyrat financiare, pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e audituesit të pavarur të jashtëm. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Anëtarët e Këshilli duhet të kenë përvojë me çështjet financiare dhe/ose me çështjet rregullatorë dhe ligjore dhe nuk mund të përfshihen në asnjë vendim që prek veprimtaritë e FMK-së.
2. Këshilli i Mbikëqyrës këshillon, ndihmon dhe mbikëqyr Bordin lidhur me monitorimin e çështjeve financiare dhe të Mbikëqyrës së FMK-së, vendos mekanizmat e Auditit dhe monitoron pajtueshmërinë me rregulloret përkatëse të FMK-së. Këshilli mbikëqyrës siguron se kontabiliteti financiar është i plotë dhe i besueshëm dhe rishikon pasqyrat financiare, pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm. Këshilli i Mbikëqyrës, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, zbaton një program pajtueshmërie brenda FMK-së.
3. Detajet mbi përgjegjësitë e Këshilli Mbikëqyrës, bashkëpunimin e tij të brendshëm dhe çështje të tjera procedurale përcaktohen në Rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës të FMK-s.
4. Kryetari dhe anëtarët e Këshilli të Mbikëqyrës zgjidhen nga Kuvendi i Përgjithshme për një periudhë 4-vjeçare dhe mund të shkarkohen nga detyra nga Kuvendi i Përgjithshme. Ata nuk i përkasin asnjë organi tjetër të FMK-së.
5. Nëse kryetari, ose një anëtar i Këshilli të Mbikëqyrës pushon përfundimisht së kryeri funksionet e tij zyrtare gjatë mandatit, bordi emëron një zëvendësues për të shërbyer deri në Kuvendin e Përgjithshme të ardhshme.

### NENI 48

#### KOMISIONET E FEDERATËS

1. Komisionet e FMK-se janë:
  - a) Komisioni i Garave;
  - b) Komisioni Profesional
  - c) Komisioni i Statusit të Mundesav ;



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

- d) Komisioni i Referve;
- e) Komisioni Ligjor;
- f) Komisioni i Mjekësor;
- 2) Komisionet e përkohshme

### **a) Komisioni i regjistrimit/ licencimit të klubeve sportistëve trajnerve**

- b) Komisioni i Verifikimit
- c) Komisioni Dicipinor
- d) Komisioni i Ankesave

2. Kryetarët dhe anëtarët e komisioneve Verifikimit, Dicipinor, Ankesave nuk mund të jenë anëtarë të Bordit, me përjashtim të Komisionit të referve, garave, profesional, Statutit të mundesav, Ligjor të cilët mund të jenë pjesë e Bordit. Anëtarët e secilit komision të përhershëm emërohen nga Bordi me propozim të anëtarëve të Bordit FMK-së. Bordi siguron përfaqësimin e duhur të femrave në komisionet e përhershme. Kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme caktohen për një mandat 4-vjeçar.

3. Çdo kryetar përfaqëson komisionin e tij të përhershëm dhe e kryen detyrën në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregulloretë Brendshëm të FMK-së, të miratuar nga Bordi.

4. Çdo kryetar cakton datat e mbledhjeve në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, siguron kryerjen e të gjitha detyrave dhe i raporton Bordit të FMK.

5. Çdo komision i përhershëm mund ti propozojë Bordit me shkrim ndryshimet e nevojshme në dispozitat përkatëse të Rregullores së Brendshëm të FMK-së që kanë të bëjnë me komisionin përkatës.

6. Komisioni i përhershëm nuk ka fuqi vendimmarrëse, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë statut ose rregulloret e organizimit të brendshëm të FMK-së

### **NENI 49**

#### **KOMISIONI I GARAVE**

Komisioni i Garave mbikëqyr organizimin dhe zhvillimin e garave të organizuara nga FMK, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e FMK-së duke pasur të drejtë të propozojë përmirësime në rregulloret përkatëse apo strukturën e garave. Komisioni i Garave përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë, Komisioni i garave përgatit kalendarin e garave dhe i dërgon bordit për miratim.

### **NENI 50**

#### **KOMISIONI PROFESIONAL**

Komisioni Profesional do të jetë kompetent për analizimin e aspekteve themelore të trajnimit dhe zhvillimi të mundjës. Ai është përgjegjës për programet zhvillimore të FMK-së, duke hartuar dhe propozuar strategji të përshtatshme për dhënien e suportit dhe monitorimin e zbatimit të strategjive karshi anëtarëve duke ofruar asistencë për Bordin për çështjet e zhvillimit në përgjithësi. Komisioni përbëhet nga një kryetar, dhe 2 (dy) anëtarë.

### **NENI 51**

#### **KOMISIONI I STATUSIT TË MUNDESAV**

1. Komisioni i Statusit të mundësav së bashku me sekretarin gjeneral do të monitorojë zbatimin e çështjeve të kalimit, transferimit të mundësav në përputhje me Rregulloret e FMK-së për kalimin e mundësav nga klubi në klub. Bordi mund të aprovojë rregulloret të posaçme për kalimin e mundësav nga klubi në klub. Komisioni i Statusit të mundësav Komisioni përbëhet nga një kryetar, dhe 2 (dy) anëtar.

2. Mosmarrëveshjet e lidhura me statusin e mundësav që përfshijnë FMK-në, anëtarët, klubet, mundesat, zyrtarët, ndërmjetësit etj, do të zgjidhen nga komisioni i apelit.

1. Statusi i mundësav dhe dispozitat për regjistrimin/transferimin e tyre do të rregullohen në përputhje me rregulloret për kalimin e mundësav nga klubi në klub.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

2. Mundësat do të regjistrohen në përputhje me rregulloret e FMK-së.

### NENI 52

#### KOMISIONI I REFERVE

Komisioni i Referve implementon rregulloren e garave FMK. Komisioni emëron referet dhe pozitat e tyre në garat të organizuara nga FMK duke administruar çështjet e arbitrimin në bashkëpunim me administratën si dhe duke monitoruar edukuar e trajnuar referet. Komisioni i referve përbëhet nga një kryetar dhe 2 (dy) anëtarë.

### NENI 53

#### KOMISIONI LIGJOR

Komisioni Ligjor mbikëqyr respektimin, propozon plotësim ndryshimin e statutit dhe rregulloreve të FMK përmes azhurnimit të normave juridike në përputhje me standardet e Federatës Botërore/Evropiane të Mundjes , Ligjin për sport, Ligjin për organizata jo qeveritare, Ligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në sport, me propozim të Bordit të FMK . Ai mbikëqyr cilësinë e vendimmartjes së organeve gjyqësorë të FMK dhe raporton përpara Bordit mbi aktivitetin e tyre. Komisioni Ligjor përbëhet nga një kryetar dhe pesë anëtarë , ku 2 prej tyre duhet të jenë me fakultet juridik.

### NENI 54

#### KOMISIONI I MJEKSOR

Komisioni mjekësor përbëhet nga tre anëtarë, të cilët zgjedhën nga Bordi i -FMK. me mandat katër vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër. Komisioni mjekësor është përgjegjës për medicinën sportive, dhe për të mbrojtur shëndetin e sportistëve.

Ky Komision organizon kontrolle të rregullta mjekësore të sportistëve dhe i informon ata në lidhje me rregullat dhe nenet për Anti Doping, nga lista e WADA ( World Anti Doping Organisation ), valid për vitin kalendarik.

### NENI 55

#### KOMISIONI I REGJISTRIMIT/ LICENCIMIT TË KLUBEVE SPORTISTËVE TRAJNERVE

1. Organet e licencimit të klubeve janë përgjegjëse për sistemin e regjistrimit/licencimit të klubeve, sportistëve, trajnerëve brenda FMK-së në përputhje me Rregulloren e regjistrimit/Licencimit të Klubeve të FMK-së.
2. Organet e regjistrimit/licencimit të klubit , sportistëve, trajnerëve përbëhen nga një organ i shkallës së parë i cili është Komisioni i Licencimit të Klubeve dhe një organ apelimi i cili është Komisioni i Apelit.
3. Detajet mbi përgjegjësitë e Komisionit të regjistrimit/Licencimit të Klubeve, sportistëve, trajnerëve bashkëpunimin e tij të brendshëm dhe çështje të tjera procedurale përcaktohen në Rregulloren e Komisionit të regjistrimit/Licencimit të Klubeve,sportistëve trajnerve të FMK-s.
4. Vendimet e miratuara nga organi i komisionit te apelit për regjistrimit/ licencimin e klubeve, sportistëve, trajnerëve mund të apelojnë vetëm pranë CAS-it në përputhje me parashikimet në këtë statut.
5. Komisioni i Apleti është përgjegjëse për trajtimin e mosmarrëveshjeve midis klubeve dhe mundësav në lidhje me çështjet qe kanë të bëjnë mes vete apo me FMK-në.

#### KOMISIONET E PAVARUR

### NENI 56

#### PAVARËSIA INSTITUCIONALE

1. Komisionet e pavarura, si dhe anëtarët e tyre, kryejnë aktivitetet dhe detyrat e tyre plotësisht të pavarur, por gjithmonë në interes të FMK-së dhe në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj.
2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Përputhshmërisë, Komisionit të Verifikimit dhe organeve gjyqësore respektojnë kriteret e pavarësisë siç përcaktohet në paragrafin 3 më poshtë.





# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

3. Personat e përmendur në paragrafin 2 më sipër, si dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre nuk mund të ushtrojnë ose të kenë ushtuar gjatë katër viteve para fillimit të funksionit të tyre ndonjë funksion ekzekutiv në FMK, brenda një prej Anëtarëve "Anëtar i ngushtë i familjes" i lidhur me një person do të thotë bashkëshorti ose bashkëjetuesi i personit në fjalë, vëllezërit e motrat, prindërit, gjyshërit, xhaxhallarët, hallat, fëmijët (përfshirë njerkun/njerkën ose fëmijë të adoptuar), kunati, kunata, vjehri ose vjehrra, dhe përfshin cilindo tjetër, qoftë me lidhje gjaku ose tjetër, me të cilin individit ka një marrëdhënie të ngjashme me një marrëdhënie familjare për të cilën personi në fjalë ofron mbështetje financiare.

### NENI 57 KOMISIONI I VERIFIKIMIT

1. Komisioni i Verifikimit është organi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në përputhje me këtë Statut, Rregulloren e Kuvendit të FMK-së dhe kryerjen e kontrollit të integritetit. Komisioni i Apelit shqyrton ankesat kundër vendimit të Komisionit të Verifikimit.  
2. Përbërja dhe funksioni i Komisionit të Verifikimit rregullohen nga Rregullorja e Kuvendit të Përgjithshme e FMK-së.

### NENI 59 ORGANET GJYQËSORE

1. Organet gjyqësore janë:  
a) Komisioni Disiplinor dhe Etikës;  
b) Komisioni i Apelit;  
2. Organet gjyqësore duhet të përbëhen në mënyrë të tillë që anëtarët, së bashku, të kenë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e specializuar që është e nevojshme për realizimin e duhur të detyrave të tyre. Kryetarët, anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe Etikës, Komisionit të Apelit, duhet të jenë të kualifikuar si juristë, me më shumë se 1 vite eksperiencë profesionale, apo të jete isha sportist apo njohës të sportit.  
3. Të gjithë anëtarët kanë mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhje sipas rregullave të këtij statuti.  
4. Kryetarët dhe anëtarët e tjerë të organeve gjyqësore zgjidhen nga Bordi dhe nuk duhet të jenë anëtarë të asnjë organi tjetër të FMK-së.  
5. Nëse kryetari ose një anëtar i një organi gjyqësor i ndërpritet kryerja e funksionit zyrtar gjatë mandatit të tij, Bordi emëron një zëvendësues.  
6. Përgjegjësitë dhe funksioni i organeve gjyqësore përcaktohen në Rregulloren e Disiplinore dhe Etikës të FMK-së.

### NENI 60 KOMISIONI I DISIPLINOR DHE I ETIKËS

1. Komisioni i Disiplinor dhe i Etikës përbëhet nga 3(tre) anëtarë, kryetari dhe dy anëtarë.  
2. Komisioni i Disiplinor dhe Etikës, si rregull, shqyrton çështjet në trupa gjyqësore me tre anëtarë, të emëruar nga kryetari rast pas rasti. Përjashtimet mund të përcaktohen në Kodin e Disiplinës dhe Etikës të FMK-së, i cili mund të parashikojë që kryetari, nënkryetari ose një anëtar që vepron si kryetar ad hoc, të shqyrtojë çështje të veçanta si gjyqtar i vetëm.  
3. Funksioni i Komisionit të Disiplinor dhe Etikës rregullohet nga Rregulloja Disiplinor edhe Kodi i Etikës i FMK-së.  
4. Komisioni i Disiplinor dhe Etikës mund të japë sanksionet e përshkruara në këtë statut dhe rregulloren e komisionit Disiplinor dhe Kodin Etikës të FMK-së për anëtarët, zyrtarët, mundësat, klubet.  
5. Këto dispozita nuk prekin kompetencat e Kuvendit të Përgjithshme dhe Bordit në lidhje me pezullimin dhe përjashtimin e anëtarëve.



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

---

### NENI 61

#### KOMISIONI I APELIT

1. Komisioni i Apelit përbëhet nga kryetari, dhe 2(dy)anëtarëve të tjerë.
2. Komisioni i Apelit, si rregull, shqyrton çështjet në trupa me tre anëtarë rast pas rasti. Rregullorja e Disiplinore dhe kodi Etikës i FMK-së mund të parashikojë përjashtime dhe, në veçanti, ngarkojë kryetarin ose dy anëtar që veprojnë ad hoc, të marrin një vendim mbi ankesa që janë të papranueshme, të bazuara ose të pabazuara.
3. Funksioni i Komisionit të Apelit rregullohet me rregulloren disiplinore dhe Kodin e Etikës të FMK-së.
4. Komisioni i Apelit është përgjegjës për trajtimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit të Verifikimit, Komisionit Disiplinor dhe Etikës.
5. Vendimet e dhëna nga Komisioni i Apelit mund t'i referohen vetëm CAS në Kosovë, CAS në Lozanë.

### NENI 62

#### ARBITRAZHI

1. Mosmarrëveshjet brenda FMK-së ose mosmarrëveshjet që prekin anëtarët e FMK-së, klubet, anëtarët e klubeve, mundesat dhe zyrtarët mund të animohen në shkallën e fundit (d.m.th. pas shërimit të të gjitha forumeve të brendshme të FMK-së) në CAS në Kosovë, CAS në Kosovë i cili jep zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjet duke përjashtuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.
2. Mosmarrëveshjet e nivelit ndërkombëtar që lindin ose lidhen me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e UWW-se ose KOK mund të paraqiten në shkallën e fundit në CAS-it në Lozanë siç përcaktohet në statutin e UWW-s.

### NENI 63

#### JURIDIKSIONI

1. FMK-ja ka juridiksion mbi mosmarrëveshjet e brendshme kombëtare, d.m.th. mosmarrëveshjet midis palëve që i përkasin ose janë të lidhura me FMK-në.
2. UWW ka juridiksion mbi mosmarrëveshjet ndërkombëtare, d.m.th. mosmarrëveshjet midis palëve që u përkasin shoqatave dhe/ose konfederatave të ndryshme, në përputhje me rregulloret përkatëse.
3. FMK do të sigurojë pajtueshëmëri në e të gjithë subjekteve që i nënshtrohen juridiksionit të saj, me çdo vendim përfundimtar të miratuar nga një organ i UWW-s ose CAS-it.

## VIII. FINANCAT

### NENI 64

#### PERIUDHA FINANCIARE

1. Periudha financiare e FMK-së është një vit, ajo fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
2. Të ardhurat dhe shpenzimet e FMK-së menaxhohen në mënyrë që ato të ekuilibrohen gjatë periudhës financiare. Detyrat kryesore të FMK-së në të ardhmen garantojnë përmes krijimit të rezervave.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për hartimin e pasqyrave vjetore të konsoliduara të FMK-së deri më 31 dhjetor.

### NENI 65

#### TË ARDHURAT

Të ardhurat e FMK-së përfshijnë:

- a) kuotat vjetore të anëtarëve;
- b) financime nga MKRS, KOK, UWW.
- c) donacione, sponzorime.
- d) të ardhura të tjera në përputhje me objektivat e ndjekur nga FMK;
- e) çdo e ardhur tjetër në lidhje me aktivitetet e FMK;
- f) çdo e ardhur tjetër legale;



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

## SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)

### NENI 66 SHPENZIMET

FMK mbulon:

- Shpenzimet e parashikuara në buxhet;
- Shpenzime të tjera të miratuara nga Kuvendi i Përgjithshme dhe shpenzime që Bordi ka të drejtë të kryejë brenda fushës së kompetencave të tij;
- Të gjitha shpenzimet e tjera në përputhje me objektivat e ndjekura nga FMK.

### NENI 67 AUDITUESI I PAVARUR I JASHTËM

Audituesi i pavarur i jashtëm të emëruar nga Bordi, kontrollojnë çdo vit llogaritë e miratuara nga Komisioni mbikëqyrës në përputhje me parimet e duhura të kontabilitetit dhe paraqesin një raport para Asamblesë së Përgjithshme. Raporti i auditimit i kalohet Bordit dhe duhet t'i kalohet pa ndryshime Kuvendit të Përgjithshme për miratim. Audituesi e pavarur i jashtëm emërohen nga Bordit Ekzekutiv, për një periudhë 4-vjeçar me mundësi vazhdimi. Mandati i tyre mund të rinovohet.

### NENI 68 KUOTAT E ANËTARËSISË

- Kuotat e anëtarësimit për anëtarët vendosen nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe paguhen brenda datës 04- 31 Janar të çdo viti. Kuota vjetore për anëtarët e rinj për vitin në fjalë paguhet brenda 30 ditëve nga përfundimi i Kuvendit të Përgjithshme që i ka pranuar ata.
- Kuvendi i Përgjithshëm përcakton shumën e kuotës vjetore çdo katër vite me rekomandimin e Bordit. Kuota është e njëjtë për çdo anëtar dhe do të jetë jo më shumë se 200.00 (dyqind) Euro.

### NENI 69 BOTIMI I TË DHËNAVE FINANCIARE

- FMK boton në faqen e saj zyrtare dokumentet financiare të përmendura në nenin 34, paragrafi 2 "i", "j" dhe "k" të këtij statuti pasi pikat përkatëse të jenë miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm.
- Shpërblimi i anëtarëve të Bordit (përfshirë Kryetarin), Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura do të bëhet rregullisht publike (p.sh. përmes botimit në faqen zyrtare të FMK-së).

### NENI 70 KONFLIKTI I INTERESIT

- Çdo anëtar i organeve duhet të tërhiqet nga diskutimet dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku ose mundësia e konfliktit të interesit.
- Në veçanti, anëtarët e organeve duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshëm dhe të veprojnë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Etikës të UWW-s mbi konfliktin e interesit dhe të rregullojnë sjelljen e tyre kur është e nevojshme (p.sh. të abstenojnë nga kryerja e detyrave të tyre, të njoftojnë kryetarin në rastet e konflikteve të mundshme të interesit, etj.).
- Kryetari dhe Sekretarin e Përgjithshëm nuk mund të jenë njëkohësisht edhe Kryetar i klubit që është anëtarë në FMK.

### NENI 71 TË DREJTAT

- FMK dhe anëtarët e saj janë pronarët origjinalë të të gjitha të drejtave që burojnë nga gara dhe aktivitete të tjera që kryhen nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim për sa u përket përmbajtjes, kohës dhe vendit. Këto të drejta përfshijnë, ndër të tjera, çdo lloj të drejte financiare, regjistrim audioviziv dhe radiofonik, të drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat multimediale, të drejtat e marketingut dhe



# FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

**SHTËPIA E SPORTIT**

**ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË  
TEL/FAX: + 00381 221 811 \*\*\* [www.kosova-wrestling.com](http://www.kosova-wrestling.com)**

promovimit dhe të drejtat jomateriale, siç janë emblemat dhe të drejtat që rrjedhin nga ligji për të drejtat e autorit.

2. Bordi vendos se si dhe deri në çfarë mase përdoren këto të drejta dhe harton rregullore të veçanta për këtë qëllim. FMK sigurohet që shitja e këtyre të drejtave të kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me statutin dhe rregulloret e FMK-së, si dhe ligjet kombëtare në fuqi.

## **NENI 72 MIRATIMI**

Klubet, ose çdo grup tjetër që janë të lidhur me FMK-në nuk mund të marrin pjesë në gara në territorin e një Federate tjetër pa autorizimin e FMK.

## **NENI 73 BOTIMI I DOKUMENTEVE TË FEDERATËS**

FMK-ja boton në faqen e saj zyrtare të internetit dokumentet dhe informacionin e mëposhtëm:

- a) Statutin dhe vendimet e Kuvendit të Përgjithshme;
- b) Rregulloren e Kuvendit të Përgjithshme;
- c) Rregulloren e Komisionit e Disiplinor dhe kodin e Etikës;
- d) Rregulloret e Organizimit të Brendshëm;
- e) Vendimet më të rëndësishme;
- f) Strategjinë e saj;

## **NENI 74 SHPËRBËRJA E FEDERATËS**

1. Çdo vendim në lidhje me shpërbërjen e FMK-së kërkon shumicën e dy të tretave të të gjithë anëtarëve me të drejt vote në FMK. Vendimi duhet të merret në një Kuvend të Përgjithshme të thirrur posaçërisht për këtë qëllim.

2. Në rast të shpërbërjes së FMK-së, Kuvendi do të tregojë emrin e shoqatës që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Shoqata(t) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse organizata.

## **NENI 75 HYRJA NË FUQI**

Ky statut u miratua nga Kuvendin e Jshtezakonshe me date 06.10.2022 dhe hyn në fuqi më 07.10.2022. Statuti i mëparshëm i FMK-së i datës 18.12.2018 shfuqizohet.

## **NENI 76 DISPOZITA TRANZITORE**

1. Anëtarët e FMK-së, duhet t'i adaptohen këtij Statuti dhe duhet t'i aplikojnë dispozitat e kërkuara në Statutet e tyre dhe rregulloret përkatëse.

**Prishtinë më 06.10.2022**

Sekretari i Përgjithshëm i FMK-se :  
Genc Fazlija

Kryetari i FMK-se:  
Naim Muja